



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 280 prot.

Fushë-Arrëz, më 30.01.2026

PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 30.01.2026, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Afrim Ndoj; Bardhok Qafa; Besjana Marku; Franc Doda; Lezina Ceca; Lin Prendi; Pavlin Qafa; Valentina Lleshaj; Vjollca Tabakaj; Tereze Dema; Zef Cara**
(12 këshilltarë nga 15 gjithsej);
- Në mbledhje merr pjesë për një interval kohor Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri**.

Gjithashtu ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **Specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas agjendës ditore. Aktualisht në sallë ndodhen 11 anëtarë të këshillit bashkiak.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **Z. Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të parë për vitin 2026, ju uroj gëzuar dhe vit të mbarë për të gjithë! Gjithashtu shpresoj të na shkojë puna mirë sikurse në 2025-ën ne si këshill. Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak sot, më 30.01.2026. Pjesëmarrja plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Përpara se të miratojmë rendin e ditës po ju bëj me dije se Kryetari i Bashkisë ka një kërkesë të datës 29.01.2025 (lexohet kërkesa) **për shtim të një pike në rendin e ditës duke e konsideruar situatën emergjentë: Rishqyrtim i Vendimit Nr.41, datë 27.11.2025 për "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi "Emergjencat Civile".**

Kërkohet dakordësia me votë për shtimin e pikës së kërkuar në rendin e ditës nga Kryetari i Bashkisë.

- Miratohet me vota të të gjithë këshilltarëve pjesëmarrës shtimi në rend të ditës i pikës, Rishqyrtim i Vendimit Nr.41, datë 27.11.2025 për “Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi "Emergjencat Civile”

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtrohet rendi i ditës me pikën e shtuar:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 30.01.2026.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.12.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike si minimum jetik duke përdorur 6 % të fondit total të ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2025.
4. Projektvendim për miratimin e kriterëve specifike për fondin 6 % të ndihmës ekonomike për vitin 2026.
5. Projektvendim për dhënie në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike), territori administrativ i bashkisë Fushë-Arrëz.
6. Projektvendim për një shtesë në Vendimin Nr. 48, datë 26.12.2025, “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026”.
7. Pikë e shtuar në rend të ditës: Rishqyrtim i Vendimit Nr.41, datë 27.11.2025 për “Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi "Emergjencat Civile”.
8. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
9. Të ndryshme.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.01.2026.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës me pikën e shtuar përmes votimit:

- Miratohet rendi i ditës me një pikë të shtuar me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.12.2025.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak: Procesverbali mban gjithçka lidhur me mbledhjen e muajit Janar 2026

Këshilltarët e kanë në dosjet e tyre secili, gjithashtu procesverbali është hedhur në web-in zyrtar të Bashkisë (Këshilli Bashkiak) menjëherë mbasi është zbardhur. Nëse keni diçka për të thënë mundeni, në të kundërt le të kalohet në votim.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.12.2025.

➤ Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.12.2025 me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 3 e rendit të ditës: Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike si minimum jetik duke përdorur 6 % të fondit total të ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2025.

Referon zyra dhe komisioni përkatës.

Lindita Lleshi, specialiste e paaftësisë dhe çeshtjeve sociale në bashki, shpjegon se për muajin Dhjetor 2025 përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës prej 6%, 28 familje, me fond 105,413 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,756,892 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën 105,285 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 46,499 lekë.
2. Njësia Administrative Qafë-Mali, 3 familje me fond 8,059 lekë .
3. Njësia Administrative Blerim, 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Administrative Fierzë, 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Administrative Iballë, 4 familje me fond 16,990 lekë .

Znj. Lleshi thekson se në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndihmë Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë të varfra ku bazohemi edhe te VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6% , është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë, të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

Lindita Lleshi, specialiste në Sektorin e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se trajtohen me ndihmën ekonomike 6% të gjitha familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, Drande

Bardhok Gjonaj, File Fran Lleshi, Gjesh Pal Marku, Lize Prend Lleshi, Mine Sadri Kopani, Ndoc Kol Prendi, Spahe Besim Zmaka, Zef Preng Mejdani.

Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Ndrenica Preng Toma (Njësia Administrative Qafë-Mali)-Ri aplikim në sistemin e Ndhimes Ekonomike.

Shtohen në bllok-ndihmën e 6% familjet:

1. Zef Preng Mejdani (Njësia Administrative Qafë-Mali).
2. Mine Sadri Kopani (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz).
3. Ndoc Kol Prendi (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz).

Lindita Lleshi, specialiste në Sektorin e Çeshtjeve Sociale: Projektvendimi ka kaluar edhe në komisionin e këshillit të bashkisë, ku është lënë të rishikohen me vëmendje emrat përfitues.

Franc Doda, anëtar i komisionit të Mirëqenies Sociale, shprehet dakord me listën emrore të përfituesve të 6 % për muajin dhjetor 2025 dhe se ky projekt është kaluar edhe në mbledhjen e komisionit përkatës të këshillit bashkiak.

Tereze Dema, anëtare e komisionit, jemi dakord me propozimet e bëra për familjet përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i bllok ndihmës prej 6 %. Duhet të ndihmohen edhe familje të tjera në nevojë për aplikim dhe të përfitojnë sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Pavlin Qafa, anëtar i komisionit të këshillit bashkiak: Jemi dakord me listen e përfituesve.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Megjenëse Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Dhjetor 2025 përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Dhjetor 2025 me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Projektvendim për miratimin e kriterëve specifike për fondin 6 % të ndihmës ekonomike për vitin 2026.

Lindita Lleshi, specialiste në Sektorin e Çeshtjeve Sociale:

Sektori i Çeshtjeve Sociale, i propozon Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz Projektvendimin për kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike prej 6% për vitin 2026 si më poshtë:

1. Të gjitha familjet, të cilat kanë aplikuar nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.

2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale, (të veja, të divorcuara).
3. Familje me shumë fëmijë.
4. Familje me fëmijë jetim.
5. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë fëmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.
7. Familje me anëtarë me sëmundje kronike.
8. Familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.
9. Përfituesit nga çdo lloj kriteri, të masës së ndihmes ekonomike prej 6%, duhet të jetë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.
10. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuara apo invalid pune.
11. Persona që jetojnë vetëm, të moshuar dhe të rinj me probleme sociale.
12. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me aftësi të kufizuar, sëmundje të rënda, të cilët nuk përfitojnë nga KMCAP-ja dhe janë në kushtë të vështira socio-ekonomike.

Në bazë të nevojave që ka Bashkia Fushë-Arrëz dhe në përputhje me ligjin, Sektori i Çështjeve Sociale i ka paraqitur pranë Këshillit Bashkiak për miratim këto kritere specifike të fondit 6% për vitin 2026, për familjet që shpallen jo fituese sipas sistemit të pikëzimit. Faleminderit!

Franc Doda, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale:

Jemi dakord me kriteret, veçanërisht kriterin me nr. 9 që thotë

“Përfituesit nga çdo lloj kriteri, të masës së ndihmës ekonomike prej 6%, duhet të jetë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz” duhet ta zbatojmë me korrektësi këtë kriter. Punonjësit përkatës duhet të sigurohen se ku banojnë personat që propozohen. Asnjë përfitues jashtë këtij kriteri nuk duhet të ketë.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për miratimin e kritereve specifike për fondin 6 % të ndihmës ekonomike për vitin 2026.

- Miratohet projektvendimi për miratimin e kritereve specifike për fondin 6 % të ndihmës ekonomike për vitin 2026 me,

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 5 e rendit të ditës: Projektvendim për dhënie në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike), territori administrativ i bashkisë Fushë-Arrëz.

Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54 shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4 ; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” të ndryshuar ; VKM-ne nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 date 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” të ndryshuar ; VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore” ; Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika nr.2 , 7, 8, 9, 10 dhe 11; Urdhërit të Kryetarit nr.728 date 16.12.2025 “Për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik me objekt; “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik në ekonominë pyjore Iballe-Mezi 1&2 (Pjesa Mezi), për energji të rinovushme (fotovoltaike)” ; Shkresën nr. 222 datë 12.12.2025 “Dërgim i Raportit Tekniko-Ekonomik me objekt; “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik në ekonominë pyjore Iballe-Mezi 1&2 (Pjesa Mezi), për energji të rinovushme (fotovoltaike)” nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, i propozojmë Këshillit Bashkiak, fillimin e procedurave për dhënie në përdorim/qira me anë të konkurimit publik (ankand) të sipërfaqes së fondit pyjor publik sipas Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika nr.2 , 7, 8, 9, 10 dhe 11, që i përket ekonomisë Iballe-Mezi 1&2 (Pjesa Mezi), në ngastrat nr. 74/b, 75/c, 76/b, 78/b, 79/b, 80/b, 82/b, 83/b në zonën kadastrale nr.1054 me nr. Pasurie; 270, 273, 276, 277 dhe 280, në sipërfaqe prej 15.1259 ha për “Energji të rinovushme (fotovoltaike)”, (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj)”, me afat përdorimi/qiraje, 10 (dhjete) vite.

Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit (ankandit) është; 143,000 leke/ha/vit dhe për 15.1259 Ha është; 2,163,004 Lekë/Vit në sipërfaqe me bimësi pyjore/djerr, e përllëgaritur kjo sipas VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore”.

Qëllimi i përdorimit është dhënia në përdorim/qira të përkohshëm të sipërfaqes fond pyjor Energji të rinovushme (fotovoltaike), (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)”. Gjithçka është e pasqyruar në Relacionin shprehës.

Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurimit (ankandit) për subjektet që konkurojnë do të jenë:

Nr .	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku	20

	objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	
2	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25
4	Nivelin e punësimit në veprimtari	5
5	Masën e qirasë për lek/ha/vit	35

Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurim është:

Përsoneat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- Nivelin e punësimit në veprimtari;
- Lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar / Vlerësim i Ndikimit në Mjedis paraprak (VNM).
- Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- Adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim janë:

- Garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

Të gjithë dokumentat e kërkuara në piken 5 dhe 6 duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Këshilltarët kanë të gjithë në dosjet e tyre dokumentin e verifikimit online në e-albania nga ASHK, Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër për pasuritë nr. 277, nr. 273, nr. 276, nr. 280, nr. 270 (zk 1054) që përfshihen në projekt të cilat kanë rezultuar në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54 shkronja "e/1", neni 55, pika 3 dhe 4, "Për tjetërsim dhe dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor", kërkohet miratimi i projektvendimit nga Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Sa janë të ardhurat që përfiton bashkia përmes këtij projekti?

Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Të ardhurat e bashkisë përmes këtij projekti janë rreth 21 milion lekë të vjetra , ky është çmimi fillestar.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

A jeni siguruar që të mos ketë konflikte nga ana e banorëve për pronat dhe pyjet dhe çfarë është thënë në dëgjesat publike?

Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Po, pyetjet tuaja shumë me vend, kemi kryer gjithë hapat dhe procedurat ligjore, është bërë edhe dëgjesa publike.

Besjana Marku, anëtare e këshillit bashkiak:

E rëndësishme është të mos preken pronat e banorëve në zonën ku shtrihet projekti.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për dhënie në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike), territori administrativ i bashkisë Fushë-Arrëz.

- Miratohet projektvendimi për dhënie në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike), territori administrativ i bashkisë Fushë-Arrëz me,

➤ **11 vota pro**

0 vota kundër

0 vota abstenim

Shënim: Në këtë moment mbledhjes i bashkohet anëtari i Këshillit Bashkiak, Afrim Ndoj.

Pika numër 6 e rendit të ditës: Projektvendim për një shtesë në Vendimin Nr. 48, datë 26.12.2025, “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026”.

Altin Engjëlli, Specialist për arsimin në bashki: Nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë sipas kritereve të përcaktuara në VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar me (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”. Nxënësi i vitit të parë Savio Prendi, në shkollën e arsimit të mesëm profesional Elektroteknikë “Shën Jozefi Punëtor” Rrëshen, për vitin shkollor 2025-2026, që propozohet të trajtohet me bursë e ka sjellë dokumentacionin me vonesë prandaj e kemi propozuar si shtesë të listës së dhjetorit, ku gjithsej bashkë me këtë bëhen 4 nxënës që mund të përfitojnë bursë për vitin shkollor 2025-2026.

Ne si bashki kemi patur 10 kuota por nuk kemi patur aplikime të tjera.

Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e bursës për nxënësin Savio Prendi, në shkollën e arsimit të mesëm profesional Elektroteknikë “Shën Jozefi Punëtor” Rrëshen, për vitin shkollor 2025-2026.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për një shtesë në Vendimin Nr. 48, datë 26.12.2025, “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026”.

- Miratohet projektvendimi për një shtesë në Vendimin Nr. 48, datë 26.12.2025, “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026” me,

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 7 e rendit të ditës: Pikë e shtuar në rend të ditës: Rishqyrtim i Vendimit Nr.41, datë 27.11.2025 për “Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi "Emergjencat Civile”.

Dod Pepa, Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:

Përshendetje! Kemi sjellë për rishqyrtim vendimin e dhjetorit lidhur me shtëpinë e djegur të shtetasit Sadri Dervishi kthyer nga Prefekti i Qarkut, për arsye të çmimeve. Koha nuk pret për qytetarin, *situata është emergjente*.

Ne kemi bërë të gjitha procedurat përfshirë edhe kërkesat me fatura disa here edhe në e-albania për ndërtimin e preventivit me çmimet që kërkojnë. Në fakt nuk kemi një përgjigje nga sistemi e-albania. Në këto kushte duke qenë *situatë emergjente*, jemi detyruar të hartojmë preventivin me çmime të vjetra duke bërë edhe njëherë vlerësimin e dëmit të shkaktuar.

Me datën 14.11.2025 kemi pasur djegien e banesës së familjes së Sadri Dervishi lagjia Trun i Poshtëm fshati Sakat Njësia Administrative Blerim me 10 anëtar dhe dy kurorë (familje) . Bashkia me të marrë informacionin ka bërë ngritjen e grupit të punës për verifikimin e dëmeve të shkaktëtuara nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, ku pas konstatimit të dëmit janë bërë verifikimet përkatëse duke u shënuar të gjitha në procesverbalet e konstatimit dhe më pas duke hartuar preventivin e dëmit nga ana strukturore (ndërtimore) me anë të çmimëve të integruara të ndërtimit në sistemin e-Albania në vlerën prej 2 452 713 lekë po që pas dërgimit të vendimit për konfirmim në prefekturë, nuk na është konfirmuar vendimi duke e kthyer edhe një herë për ta hartuar sipas çmimeve të ndërtimit të miratuara nga enti kombëtar i banesave në vitin 2016 të dërguara pranë bashkisë me shkresë të Prefektit Nr. 5163 datë 14.08.2017 dhe vlera e preventivit të dalë është 1 886 617 leke edhe preventivin e mobiljeve në vlerën 310 500 lekë me vlerë totale dëmi 2 197 117 leke, ku sipas VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 pika 3 paragrafi ç, masa e ndihmes financiare do të jetë 50% e vlerës së dëmit të përlogaritur dhe konkretisht 1 098 558 leke.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, në ligjin Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 8756 datë 23.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kreu III, si dhe ne Vertetimin e leshuar nga MNZ Fushë-Arrëz me datë 21.11.2025 mbi djegien e banesës së shtetasit Sadri Dervishi si dhe ne shkresën e prefektures Nr. 804/1 prot date 16.12.2025 “Mbi Vendimin Nr. 41, date 27.11.2025 të keshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, Sektori i Emergjencave Civile, Finances dhe Kryetari i Bashkisë, propozojnë:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetjen financiare të shtetasit Sadri Dervishi për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025 me vlerë demesh të preventivit strukturor në vlerën e 1 886 617 leke dhe preventivit të mobiljeve në vlerë 310 500 leke me vlerë totale demit 2 197 117 leke.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Fushë-Arrëz për familjen e demtuar .
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Z. Sadri Dervishi agjia Trun i Poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim ndihmën emergjente në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetemijë) lekë nga buxheti i bashkisë Fushë-Arrëz, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga këshilli i bashkisë për vitin 2026.
4. Ndihma financiare për familjet e shtetasve Sadri Dervishi, të përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 dhe . ligjin Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”
5. Për shpërblimin e demit të përdoret fondi i Emergjencave Civile i cili sistemohet në programin ekonomik si me poshte: 17-10910-01,604-1009.
6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për të ardhur në ndihmë familjes së sipër cituara, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për Rishqyrtim të Vendimit Nr.41, datë 27.11.2025 mbi “Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi “Emergjencat Civile”.

- Miratohet projektvendimi për Rishqyrtimin e Vendimit Nr.41, datë 27.11.2025 mbi “Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtëm fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkisë, programi “Emergjencat Civile” me,

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 8 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Kemi një kërkesë nga Kryesia e fshatit Fushë-Arrëz me Kryetar Lekë Curri dhe kjo nuk është hera e parë që e trajtojmë këtë çështje.

Kemi një kërkesë nga Kryesia e fshatit Fushë-Arrëz drejtuar këshillit të bashkisë, mbi disa shqetësime për çështje pronësie toke që kanë mes njëri-tjetrit tre vëllezër,

(djemtë e Z. Basri Selimaj), përkatësisht Hysni, Xhevat dhe Beslim Selimaj.

Konkretisht këta vëllezër i kanë këto problematika tek toka ku ka banesën Xhevat Selimaj dhe krahas tij ka ndërtesën e punës dhe token Hysni Selimaj. Problematika mes tyre ka lindur mbas shumë vitesh të ndarjes së tokës nga babai i tyre Basri Selimaj. Mbasi kanë ndarë tokën të tre vëllezërit kanë rënë dakord që në krye të tokës së tyre, paralel dhe ngjitur me rrugën kombëtare të asfaltuar, të lihet rrugë për lëvizjen e automjeteve për të hyrë dhe për të dalë në tokën e tij secilit nga djemt. Ndarja e tokës së Basri Selimaj mes tre djemve të tij është shoqëruar me një

deklaratë ku është përcaktuar qartë, për krye të tokës së tyre, paralel dhe ngjitur me rrugën kombëtare të asfaltuar, të lihet rrugë për lëvizjen e automjeteve për të hyrë dhe për të dalë në tokën e tij secilit nga djemt: “ Rruga e makinës do të jetë e pa bllokuar për të tre djemt”, kështu thuhet në deklaratë. Kjo deklaratë është formuluar dhe firmosur nga të tre djemt e Basri Selimaj, Hysni, Xhevat dhe Beslim Selimaj. Aty kanë pasë tokën e tyre të trashëguar edhe tre vëllezërit e Basri Selimaj.

Me kalimin e viteve Xhevati ka blerë tokën e xhaxhallarëve të tij, Sulltan dhe Ismet Selimaj dhe këto të fundit i ka me dokumenta si pronë e tij.

Problematika aktualisht është se Xhevat Selimaj nuk lejon vëllain e tij Hysni Selimaj të kalojë me automjet me hy në tokën e tij që e ka krahas me banesën dhe biznesin e Xhevati Selimi. Ka probleme edhe mes Beslimit (vëllait tjetër) dhe Xhevatit lidhur me sistemin e tokave të tyre, por Beslimi thotë se jam drejtuar organeve të drejtësisë për këto çështje.

Aktualisht problematika e bllokimit të rrugës për të shkuar te toka e tij Hysni Selimaj nga i vëllai Xhevat Selimaj, qëndron e pazgjidhur.

Ne si Kryesi Fshati e kemi analizuar me kujdes, ku Kryetari i Fshatit Z. Lekë Curri, ka bërë disa takime me të tre vëllezërit dhe ju ka dhënë opsione për mundësi zgjidhje, konkretisht:

1.Xhevat Selimaj të mbyllë gropën e riparimit të automjeteve. Kështu Hysni Selimaj, duke filluar nga porta e përbashkët e hyrjes deri te toka e tij të bëjë gardh ose mur ndarës me oborrin e Xhevatit.

2.T’i japë Xhevat Selimaj aq tokë sa ka Hysni Selimaj në mes të tokës së Xhevatit dhe Beslimit (ndërrim vendi).

3. Xhevati, nëse e lejon autoriteti i rrugëve kombëtare të rregullojë rrugën për hyrje-dalje të rregullt me automjet hysni Selimaj në tokën e tij.

4. Xhevati aty ku kufizohet nga vëllai tjetër Beslimi, nga rruga kryesore deri në fund të parcelës të lejojë rrugë automjeti për të hyrë e dalë në pronën e tij Hysni Selimaj.

Ne si Kryesi Fshati, jemi përpjekur dhe i kemi këshilluar këta tre vëllezër të zgjidhin këto mosmarrëveshje me njëri-tjetrin në prani të prindërve të tyre.

Mundësitë tona këto janë, këshillim dhe dhënie mendimi për zgjidhje ashtu siç e mendojmë.

Nga një kopje të këtij dokumenti do t’ju japim të tre vëllezërve, Hysni, Xhevat e Beslim Selimaj.Kryetar i Fshatit Fushë-Arrëz, Lekë Curri.

Prezent në sallë janë Basri dhe Ishe Selimaj, prindërit e djemve në konflikt për rrugën.

Gjithashtu mbledhjes i bashkohet për këtë pikë *Gjelosh Guga*, specialist kadastrë, njohës i çështjes, dhe me vonë në mbledhje merr pjesë edhe *Redona Hasani*, Juriste në bashki.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Kryesia e fshatit ka dhënë disa alternativa se si mund të zgjidhet problematika.

Ne që jetojmë këtu e dimë se ku është objekti. Unë personalisht i kam takuar dhe kam biseduar me Xhevatit dhe Hysnin, me sa di unë edhe kryetari i bashkisë dhe Bardhoku kanë ba takime secili më vete. Sot jemi në një pikë që problematika ka më shumë se 3 muaj që nuk është zgjidhë Akoma.

Ka një deklaratë (lexohet dekarata) të ndarjes së tokës se Basri Selimaj (babai i Hysni, Xhevat dhe Beslim) të firmosur nga të tre vëllezërit ku thuhet në fund “ Rruga e makinës do të jetë e pa bllokuar për të tre djemt”. Tani fjala për kryetarin e bashkisë.

Hil Curri, Kryetar i bashkisë:

Unë kam ba takime me Xhevatit i cili ka bllokuar rrugën Hysnisë dhe i kam propozuar që në këtë situatë zgjidhja më e drejtë është ajo me konsensus mes tyre, ku Xhevati të hapë rrugën,

sepse janë mes vëllezërish, bazuar edhe në një deklaratë që kanë nënshkruar të tre si vëllezër kur babai i tyre iu ka ndarë pronën e trashëguar. Personi në fjalë që ka bllokuar rrugën nuk i qëndron aktualisht deklaratës dhe në raste të tilla kur njëri nuk i qëndron deklaratës, ajo nuk ka formë më. Zgjidhja bazuar në këtë deklaratë do të ishte zgjidhja me më pak pasoja për këtë çështje. Zgjidhjet e tjera si, ndërhyrja e shtetit, ndërhyrja e IKMT-së, ndërhyrja e krimit ekonomik etj. ka pasoja jahtëzakonisht të mëdha. E vërtetë është se Xhevati që ka bllokuar rrugën Hysnisë, kur e kam takuar, ka pranuar pjesërisht zgjidhjen por një marrëveshje përfundimtare nuk e arritëm. Unë mendoj të shkojmë edhe njëherë me përfaqësues nga këshilli bashkiak. Unë kam qenë edhe me shefin e komisariatit, Basriu e di këtë se ka qenë present ku kemi bërë debat 3-4 orë për këtë çështje. Unë kam pasë kërkesë për këtë çështje edhe nga Kryeministria, nga portalet, nga Drejtoria e përgjithshme, Drejtoria e policisë, ku të gjithë më kanë vënë në dijeni për çështjen. Para dy ditësh kam qenë me OPGJ sepse situata aty është shumë e agravuar dhe deklaratat e tyre janë për vetëgjyqësi dhe në këtë rast vihen të gjithë në lëvizje. Mendoj që kjo zgjidhet duke hap Xhevati rrugën vëllait të tij duke shtyre 3m gardhin. Këta e kanë ngrit si çështje por prokuroria nuk është marrë me atë pjesë për të përcaktuar se ku është tokë shtetërore dhe ku është tokë me tapi, prandaj konsensusi është zgjidhja më e drejtë në këtë rast.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Gjelosh, ku jemi me situatën administrative ligjore të pronës për çështjen në fjalë ?

Gjelosh Guga, specialist Kadastre (i përfshirë privatisht në këtë çështje):

Unë jam ekspert dhe po shpjegoj nga ana ligjore si i përfshirë privatisht (jo nga ana shtetërore) në këtë çështje.

Kjo që po shpjegoj unë lidhur me këtë çështje ka qysh në vitin 2021. Unë jam marrë me këtë çështje si ekspert privat dhe që aty kam parë një mosdakordësi për këto prona. Do flas me emra që të jem i qartë dhe i kuptueshëm.

Unë e kam marrë trajtimin e tokave të tyre në rrugë ligjore me hartë nga hipoteka e Pukës dhe kam konstatuar që këtu pronat nuk janë të hedhura ashtu siç janë defakto në terren. Duke qene se kam gjetë një handikapati në pronat e hedhura në hartë, unë i kam shpjegu që secili nga vëllezërit duhet të regjistrojë pronën e tij dhe kështu ranë dakord të tre vëllezërit. Ai që i preu në besë vëllezërit ishte Xhevati i cili u tregua i papërgjegjshëm në lidhje me regjistrimin e tokave të vllaznisë. Xhevati në mënyrë të njëanshme dhe pa dijeninë e vëllezërve të tij ka marrë Certifikatë pronësie për pjesën e pronës që ka Ismeti (xhaxhai i tyre) pa ba deklaratë noteriale me kufitarët, ku ndërkohë ky i fundit e ka ditur që është toka e vëllait sepse ka qene tokë e trashëguar ndër vite, pra Xhevati ka qenë molla e sherrit të kësaj pune i cili nuk pati dakordësi. Njësoj ka bërë me të gjitha pjesët që i ka privatizuar pa deklarata kufitarësh gjë të cilën e kërkon ligji. Kështu që aty janë regjistruar tokat në mënyrë të paligjshme.

Kjo që po shpjegoj ka ndodhur në viti 2021 kur unë po merresha privatisht si ekspert dhe jo si përfaqësues institucioni. Aty gjenden 3 pasuri për të cilat Këshilli bashkiak duhet t'i kërkojë ASHK-së për këto 3 pasuri, llojin e tyre dhe gjendjen juridike të pasurive.

Hil Curri, Kryetar i bashkisë pyet: Tapitë e Xhevatit deri ku shkojnë? A ka distancë toke nga toka me tapi deri te rruga nacionale?

Gjelosh Guga, specialist Kadastre:

Thashë që aty janë 3 pasuri dhe ju duhet të merrni gjendjen juridike të tyre te Kadastra dhe në përgjigjen e gjendjes juridike të këtyre pasurive do të merrni përgjigjen. Xhevati po bën rolin e Prokurorit, gjykatësit, këshillit, bashkisë, në një kohë që Xhevati nuk ka të drejtë fare.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Në dijeninë tënde si ekspert, si është gjendja juridike e pronës për të cilën bëhet fjalë (pjesa e kapanonit, gropës së servisit dhe pjesa aty ku bëhet fjalë për rrugën), pra aty ku është edhe konflikti i bllokimit të rrugës?

Gjelosh Guga, specialist Kadastro: Në dijeninë time ato të gjitha ku pyete janë me status tokë-shtet. Këto të dhëna unë i kam marrë privatisht, por të ligjshme. Nga 2021 e këtej mbase mund të ketë ndonjë ndryshim.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Domethënë pjesa për të cilën po diskutojmë dhe ku është bllokuar rruga është tokë-shtet po thoni Gjelosh.

Gjelosh Guga, specialist Kadastro:

Gjendja juridike e pasurive ndryshon vazhdimisht sepse njerëzit punojnë nëpër harta, ka procese legalizimi dhe ndryshon harta.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Në dijeninë tënde, a ka ndryshim këto vite gjendja juridike e asaj pasurie?

Gjelosh Guga, specialist Kadastro: Dyshoj mos ka bërë ndonjë legalizim gjatë këtyre viteve.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Gjelosh kam edhe një pyetje për ty: Në dijeninë tënde sido të jetë gjendja juridike e një pronë (sido që të marrë dokumenta pronësie), një pronë a mundet të izolojë një pronë tjetër?

Gjelosh Guga, specialist Kadastro: Në mënyrë kategorike jo. Një pronë nuk izolon një pronë tjetër, kjo nuk ndodh kurrë.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Dua të pyes zyrën juridike: A jeni të njohur ju si zyrë me këtë çështje?

Redona Hasani, përgjegjëse e zyrës juridike në bashki: Po jemi të njohur me çështjen kohët e fundit. Nëse toka është shtetërore, asnjëri nuk mundet ta privatizojë dhe i bie që të jenë në shkellje të ligjit të dyja palët. Nuk mundet të bëjnë një marrëveshje në bashki nëse nuk kanë një marrëveshje me njëri-tjetrin vëllezërit që janë në konflikt.

Nëse këto do të kishin një marrëveshje me njëri-tjetrin do të bëhej servituti që e lejon kalimin. Këto kanë një marrëveshje me njëri-tjetrin e cila del e pavlefshme sepse toka është shtetërore dhe nuk kanë marrë leje nga ARRSH-ja.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Nëse një rrugë është funksionale për shumë vite për një person dhe djali i tij rritet për 25 vjet me radhë duke kaluar në atë rrugë dhe një ditë befas i thua kjo rrugë s'është e jotja, kjo nuk ka kuptim. Në dijeninë time nëse një person ka kaluar pandërprerje dhe pa kundërshtime për 25 vjet në rrugën që është e vetmja hyrje-dalje, atëherë krijohet e drejta e kalimit edhe pa kontratë të shkruar, (servitut kalimi). Në njëfarë forme, qoftë edhe pa letra, kjo është një marrëveshje më vete pa llogaritur që këta vëllezër kanë pasë edhe një marrëveshje me shkrim me njëri-tjetrin kur kanë marrë hisen e tyre secili dhe e kanë nënshkruar duke lënë rrugën për të tre të pabllokuar. Prona është për shumë e shumë vite realisht, pra ne po flasim për dy gjëra, për pasjen faktike të pronës dhe për dokumentacionet e pronësisë. Shteti nuk mund të mohojë pronën për mospasje të dokumentacionit sepse bërja me letra e pronës është një proces administrativ që personi mund ta bëjë ose jo. Shteti duhet të krijojë kushtet për marrjen e dokumentacionit të

pronësisë së tokës, por kur shteti e lë personin 10 vjet apo më shumë pa mundësi ligjore, atëherë edhe njerëzit tërhiqen dhe mbeten me prona pa dokumenta pronësie pra tokat e tyre në fakt në këto kushte quhen toka shtet.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Çfarë thotë ligji për servitutin e kalimit?

Redona Hasani, përgjegjëse e zyrës juridike në bashki:

“Te kodi civil servituti thotë, nëse dy persona kanë marrëveshje me njëri-tjetrin gojariisht, munden që me ardhë me lidhë këtu në bashki marrëveshjen, që lehet e drejta e kalimit, ndryshe nëse këto nuk kanë një marrëveshje vetëm përmes gjykatës, marrëveshja e tyre është prishë”

Ishe Selimaj, nëna e djemve në konflikt për bllokim rruge pyet:

Kush e ka prishë marrëveshjen? Marrëveshja është me firmën e të tre vëllezërve.

Basri Selimaj, (babai i djemve që janë në konflikt për rrugën):

Dua të qartësoj situatën sepse diçka është e paqartë në këtë diskutim. Një ish shef kadaestre më ka thënë: A ke dokument për tokën para hyrjes në kooperative? Ja ku është dokumenti (e ka në dorë shkresën) i kadastrës në kohën e Partisë së Punës ku trashëgimtarë edhe me certifikatë trunq jam unë (ja ku e kam, tregon certifikatën). Ky dokument pronësie është i firmosur nga Rustem Struga ish-shef i Kadastrës në atë kohë, kjo është ligjore. Pra kjo tokë nuk është shtet, e tillë është bërë në kohën e demokracisë, jo në kohën para hyrjes në kooperativë. Kjo tokë është e regjistruar në kadastrë atëherë në emër të Adllah Selimit, xhaxhait tim i cili me certifikatë trashëgimie ma ka dorëzuar mua. Pra kjo tokë është pronë e imja të cilën e kam trashëguar. Unë e kam zgjidhë problemin e pronës time se si t’jua lë trashëgimtarëve të mi me drejtësi si me fe, me ligj, me kanun, me Zot.

Unë jua kam nda pronën time të tre djemve (Hysni, Xhevat, Beslim) dhe kam lënë rrugën për krye të tre pjesëve të secilit duke bërë edhe një deklaratë të cilën e kanë firmosur të tre djemt e mi. Ka 25 vjet që funksionon kështu rruga pa asnjë problem por sot situata është me bllokim të kësaj rruge nga ana e Xhevatit. Po jua them që Kadastra aktualisht ka bërë në pronën time korrigjime të paligjshme, prandaj s’po gjendet zgjidhje.

Shënim: Në këtë moment të mbledhjes del nga mbledhja anëtari i këshillit Zef Cara.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Nuk është hera e parë që ne në këshill diskutojmë të njëjtën problematikë. Unë mendoj të marrim një vendim të cilin më pas do ta gjykojë prefektura, gjykata. Ne sot duhet të dalim me një vendim. Këshilli me ligj ka të drejtë të marrë vendime për faktet të cilat i njeh, pa shkelur ligjin. Vendimet tona mund të përdoren edhe në gjykatë nëse çështja shkon atje. Ne kemi pasë një rast në Lumardh, ku gjykata ka diskutu për servitutin.

Me kalimin e viteve themi që puna e shtyn shtegun por nuk e mohon, edhe ligji kështu e thotë. Ky është rasti për të thënë që edhe nëse njëri person ka dokument pronësie për tokën nuk mund t’i mohosh tjetrit rrugën për të hyrë te prona e tij kur ky i fundit ka kaluar gjithë jetën e tij aty (janë moshë madhore të tre djemt, rreth të 60-tave).

Kryetari i bashkisë, me specialist të zyrave duhet të shikojë edhe ligjshmërinë e barakave aty me IMT e bashkisë. Nga sa u diskutua dhe kemi njohuri (vendin ku bëhet fjalë e njohim dhe e dimë të gjithë ne që jemi këtu) unë dua të bëj një propozim:

Të krijohet mundësia që shtetasi Hysni Selimaj të kalojë për të shkuar në pronën e vet siç ka kaluar tradicionalisht për vite me radhë dhe t'i kërkojmë bashkisë me vendim këshilli të shprehet me shkrim për ligjshmërinë e ndërtimeve që pengojnë kalimin e rrugës. Kryetar, kemi shkuar në atë pikë që duhet qëndrim ligjor, ne bëjmë përpjekjen që na takon, shkojmë njëherë apo dy por nuk mund të tallet askush me ne si institucion. Në fund të fundit gjykata zgjidh çdo padrejtësi. Unë nuk jam jurist, unë ngre dorën për një fakt që unë e di dhe në këtë rast unë e di që Hysniu ka fut makinën në tokën e tij aty ku bëhet fjalë, ka kaluar aty dhe në tokën e tij ai ka edhe makineri. Nga i ka fut ai ato makineri, nga ajri? Jo, për atë rrugë i ka fut dhe ka hy e ka dalë në atë rrugë për vite me radhë.

Ishe Selimaj, (nëna e djemve që janë në konflikt me njëri-tjetrin për bllokimin e rrugës). Unë dhe babai i djemve, jua kemi nda tokën sin në traditë tre djemve dhe ju kemi lënë rrugën e përbashkët për krye të tre hiseve të secilit 4m gjerësi, e firmosur nga të tre djemt në një deklaratë. Kjo ka funksionuar për rreth 30 vite rresht pa asnjë problematikë (shpreh dyshimet e saj për nxitje). Nëse dikush ka bërë dokumenta pronësie pa kufitarët ka shkelë ligjin.

Shënim: Në këtë moment të mbledhjes dalin nga salla e mbledhjes Basri dhe Ishe Selimaj.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Edhe njëherë po përpiqemi të gjykojmë që edhe juridikisht të jemi në rregull. Realisht rruga që kërkon qytetari Hysni Selimaj për të hy në pronën e tij ka qenë sepse këtë e faktin ndërtimi që ka ba aty. Janë dy shtëpi dhe tani njërit ju ka mbyll çdo shteg (Hysniut) nga do të dalë tani ky mbas 20 e ca vitesh. Ne nuk e dimë ligjshmërinë e privatizimeve aty, por sido që të jetë edhe legalizimi i çdo prone nuk mund të mohojë të drejtën e kalimit kur kjo ka ndodh për më shumë se 20 vjet.

Bardhok Qafa, anëtar i këshillit: Qytetari Hysni Selimaj është tash 25 vjet që ka kalu në atë rrugë që tashmë vëllai i tij Xhevati ia ka bllokuar. Mirë është të marrim një vendim.

Lin Prendi, anëtar i këshillit: Këto vëllezër paskan firmosur një deklaratë kur kanë ndarë tokën dhe ku paskan lënë edhe rrugën për të hyrë në pronën e secilit. Pra rruga e bllokuar duhet të hapet.

Afrim Ndoj, anëtar këshilli: Duhet të dalim në një konkluzion ku me ndihmën e përfaqësuesve të drejtorive të bashkisë dhe specialistëve të gjendet një zgjidhje.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Ka tre muaj që nuk është gjet zgjidhje.

Vendimi jonë për rihapjen e rrugës për të kaluar në pronën e tij Z. Hysni Selimaj, mbështetet: 1. te servituti i kalimit (realisht djemtë e Basri Selimaj kanë një marrëveshje me shkrim, të firmosur nga tre vëllezërit kur është ndarë toka dhe është lënë që rruga të mos jetë e bllokuar për të tre, pavarësisht se kjo deklaratë është pa noter) dhe 2. te fakti i trashëgimisë (të gjithë ne e dimë këtë fakt) që Hysniu ka kaluar më shumë se 20 vjet në atë rrugë të cilën sot ia ka bllokuar vëllai i tij Xhevati.

Pavlin Qafa, anëtar këshilli: Mendoj t'i qëndrojmë deklaratës që kanë ba vetë personat dhe e kanë firmosur.

Redona Hasani, përgjegjëse e zyrës juridike në bashki:

Me sa di unë njëri nga vëllezërit, Xhevati e hedh poshtë deklaratën duke thënë se nuk jam unë personi që kam nënshkruar deklaratën. (Juristja nuk jep detaje nga e ka marrë këtë informacion).

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Nëse deklarata është e rreme le t'i drejtohen Prokurorisë.

Afrim Ndoj, anëtar këshilli: Fatmirësisht në këtë rast ai që e ka hartuar deklaratën është gjallë, është babai i tyre dhe është krejt e lehtë të verifikohet vërtetësia e deklaratës, pra unë jam për zgjidhje sipas deklaratës. Të kthehet rruga siç ka qenë dhe siç është në deklaratë.

Bardhok Qafa, anëtar i këshillit: Kështu është dashur të vepronim që herën e parë që është diskutuar kjo çështje në këshill.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Të nderuar këshilltarë, nisur sa u diskutua edhe nga pikëpamja ligjore edhe nga pikëpamja e marrëdhënieve komunitare, me njohjen që kishim dhe që e shtuam tani (jo të gjitha gjërat i kemi ditur) unë propozoj siç u shprehët edhe ju:

Të rihapet rruga e kalimit për qytetarin Hysni Selimaj siç ka qenë mbështetur edhe në deklaratën e përbashkët të firmosur nga vetë vëllezërit, duke ditur edhe një fakt madhor që nuk mund të mohosh rrugën e kalimit për te prona e tjetrit.

Që kur është miratuar ligji 7501 ka lënë dy opsione, ndarjen për frymë dhe ndarjen sipas trashëgimisë zakonore dhe dihet që zona e veriut e ka ndarë pronën sipas trashëgimisë zakonore. Ne nuk jemi për të cënuar shtëpinë e Xhevatit por nuk mund të mohohet as hyrja e Hysnisë në tokën e tij.

Ju ftoj të votojë kush është dakord sipas variantit që diskutuam, propozimit për hapje të rrugës qytetarit Hysni Selimaj, si pikë e parë dhe pika e dytë, ngarkon Kryetarin e bashkië dhe zyrat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

- Miratohet me vota të plota të këshilltarëve present në sallë propozimi për hapjen e rrugës qytetarit Hysni Selimaj siç ka qenë mbështetur edhe në deklaratën e përbashkët të firmosur nga vetë vëllezërit për të hyrë në pronën e tij.

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 9 e rendit të ditës: Të ndryshme.

Besjana Marku: Disa prindër të nxënësve në Fushë-Arrëz kanë ankesë lidhur me ngrohjen e fëmijëve të tyre te shkolla 9-veçare e qytetit. Nuk e di se ku çalon puna por pjesën më të madhe të kohës janë pa ngrohje fëmijët. Sa kemi kuptuar problematika qëndron në faktin se është një person i vetëm që kujdeset për kaldajat edhe te gjimnazi edhe te 9-vjeçarja dhe mbase kjo është e pamundur të realizohet më së miri.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Për këtë po vemë në dijeni Kryetarin e bashkisë, i cili përmes strukturave të interesohet.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtë.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen, uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Gjollca Tabakaj
Tereze Dema
Lil' Prenok
Bashk' Pap
Zef Cerce
Franc Dodon
Gjerdin Baza
Lexina Leca
Valentina Lleshoj
Afetun Mshaj

(Handwritten signatures next to names)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT BASHKIAK TË DATËS 30.01.2026

Nr.	Emër	Mbiemër	Nr. telefoni & whatsapp (nëse ka ndryshuar)	Firma
1.	Vjollca	Tabakaj	—	
2.	Tereze	Demq	—	
3.	Besjana	Marku	—	
4.	Xhin	Prenoli		
5.	Baroket	Qafz		
6.	Zef	Curc		
7.	Franc	Dodaj		
8.	Yorlim	Refz		
9.	Lerina	Cola		
10.	Valentina	Leshaj		
11.	Nikolin	Bandolin		
12.	Agim	Mele		
13.				
14.				
15.				